



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijeno / Predato Received / Delivery	16 . 11 . 2023	3	viti god year
Organ / Mjesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
QDMSHK	6997/2023		115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1241/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demianëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1241/2023, të datës 03.10.2023 të ankuesit

kundër Vendimit me numër:721/02 të datës 28.09.2023 dhe Vendimit me numër:723/02 të datës 29.09.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.11.2023, mori:

**V E N D I M**

I. Refuzohet si e papabuar ankesa me numër A.nr.1241/2023 e datës 03.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër:721/02 i datës 28.09.2023 dhe Vendimi me numër:723/02 i datës 29.09.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

**A r s y e t i m**

Ankuesi sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tani e tuje referuar si MINT), me datë 03.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër:6371/2023, kundër Vendimit me numër:721/02 i datës 28.09.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit



të Përgjithshëm të MINIT dhe Vendimit me numër:723/02 i datës 29.09.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MINIT.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se mos aprovimi i kërkesë së datës 08.09.2023 për kompensimin prej 70% të pagës për pushim mjekësor si dhe ndalesa në pagë për shkak të tejkalimit të pushimit mjekësor prej tetë (8) ditësh nga pushimi i rregullt mjekësor, janë veprime të cilat nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe janë dhe si të tilla janë tendencioze, me supozimin se i njëjti është sëmurë gjatë orarit të punës si pasojë e stresit nga presioni i ushtruar nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë dhe se mbi bazën e nenit 12 paragrafi 4 të Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik i takon e drejta për kompensim prej 70% të pagës për pushim mjekësor, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e ankuesit ndërsa të shfuqizohen Vendimi me numër:721/02 i datës 28.09.2023 dhe Vendimit me numër:723/02 i datës 29.09.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MINIT, kurse Departamenti për Buxhet dhe Financa të obligohen për kompensimin e plotë të të ardhurave personale që kanë të bëjnë me periudhën kohore nga data 16.08.2023 deri me 06.09.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej KPMSHCK*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ndërsa me datë 11.10.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 03.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimi me numër:721/02 i datës 28.09.2023 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MINIT; Vendimi me numër:723/02 i datës 29.09.2023 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MINIT; E-mailin e datës 08.09.2023 dërguar nga ankuesi për V.R-V i orës 14:52; E-mailin e datës 16.08.2023 dërguar nga ankuesi për V. R dhe të tjerët; E-mailin e datës 08.09.2023 dërguar nga ankuesi për V.R-V i orës 14:42; E-mailin e datës 08.09.2023 dërguar nga V.R-V për ankuesin i orës 13:45 me korrespondencën e bashkangjitur; Fletë lëshimin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës i datës 29.08.2023; Raporti i ndërprerjes së përkohshme të punës i datës 06.09.2023; Kërkesa e ankuesit e datës 08.09.2023; Udhëzim për konsultime nr.regjistri:6179; Udhëzim për konsultime nr.regjistri:6179 i datës 12.08.2023 (*vështirë e lexueshme data*); Raporti mjekësor i datës 28.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.10.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 11.10.2023; Akt emërimi i datës 07.05.2015 dh përshkrimi i detyrave të punës së ankuesit; E-mailin e datës 08.09.2023 dërguar nga ankuesi për V.R-V i orës 09:01; Raporti i ndërprerjes së përkohshme të punës i datës 17.03.2023; Shkresë "kopje e sistemit SIMBNJ" për aprovimin e pushimit mjekësor i datës 22.03.2023; Shkresë "kopje e sistemit SIMBNJ" për aprovimin e pushimit vjetor i datës 07.04.2023; Shkresë "kopje e sistemit SIMBNJ" për aprovimin e pushimit vjetor i datës 18.05.2023; Shkresë "kopje e sistemit SIMBNJ" për aprovimin e pushimit vjetor i datës 20.06.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesi sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 07.05.2015 ka të



themeluar marrëdhënien e punës në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në pozitën "Drejtor i Drejtoratit për Çështje Administrative të Regjistrimit të Biznesit në ARBK", ndërsa me datë 08.09.2023 i është drejtuar Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MINT me kërkesën për aprovimin e pushimit mjekësor me pagesë në vlerën e 70% të pagës për periudhën nga data 16.08.2023 deri me datë 06.09.2023, me arsyetim se kërkesa e tij mbështetet në dispozitat e nenin 12 paragrafi 4 të Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, me arsyetimin se sipas Fletë lëshimit të datës 29.08.2023 të lëshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës-Shërbimi Endokrinologjia, i njëjti ka qenë duke u trajtuar nga data 16.08.2023 deri me datë 29.08.2023 me sugjerimin për vazhdimin e pushimit mjekësor edhe për shtatë ditë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MINIT përmes Vendimit me numër:721/02 i datës 28.09.2023 e ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 08.09.2023 për aprovimin e pushimit mjekësor me pagesë në vlerën e 70% të pagës për periudhën nga data 16.08.2023 deri me datë 06.09.2023, me arsyetimin se raporti mjekësor i dorëzuar në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore nuk reflekton me sëmundje profesionale sipas nenit 12 paragrafi 4 të Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, ndërsa me datë 29.09.2023 përmes Vendimit me numër:723/02 Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MINIT sipas pikës I dhe II të dispozitivit ankuesit i ka bërë ndalesë në pagë në vlerën prej 352.56 euro/cent në emër të tejkalimit të pushimit mjekësor prej tetë (8) ditësh nga pushimi mjekësor i rregullt prej njëzet (20) ditësh.

Sipas Raportit të ndërprerjes së përkohshme të punës të lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prishtinë me datë 17.03.2023, shkresë kjo e cila është ofruar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në cilësi të provës zyrtare, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi ka shfrytëzuar pushimin mjekësor nga data 02.03.2023 deri me datë 17.03.2023 apo dymbëdhjetë (12) ditë nga gjithsejtë njëzet (20) ditë me kompensim 100% të pagës sa janë të njohura me dispozitat e nenit 12 paragrafi 1 të Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik sikurse përcaktohet: "Zyrtari publik në rast të sëmundjes ka të drejtë për pushim mjekësor në kohëzgjatje deri njëzet (20) ditë punë brenda një (1) viti me kompensim 100% të pagës", nga rrjedh se ankuesit pas datës 17.03.2023 i kanë mbetur edhe tetë (8) ditë të pashfrytëzuara nga pushimi mjekësor me kompensim 100% të pagës për vitin kalendarik 2023.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e nenit 12 paragrafi 4 të Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se: "Zyrtari publik ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale të ndërlidhur me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për institucionin, në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune me kompensim prej 70 % të pagës së tij" si dhe nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit NR. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë i cili përcakton se: "Sëmundje profesionale - çdo sëmundje e shkaktuar nga ekspozimi në elementet e dëmshme dhe të rrezikshme kimike, fizike dhe biologjike në ambientin e punës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës" ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2012 për Kompensimin e Shpenzimeve për Lëndimet dhe Sëmundjet Profesionale të Shkaktuara në Pune ku përcaktohet se: "Varësisht nga shkalla dhe kategoria e lëndimeve, përkatësisht sëmundjeve profesionale përcaktohet diagnoza në formë të ekspertizës nga institucioni i Mjekësisë së Punës. 2. Vlerësimi i lëndimeve dhe sëmundjes profesionale kryhet në institucionet e autorizuara të Mjekësisë së Punës në formë të ekspertizës", ka ardhur në përfundimin se nepunësve civil në parim u takon e drejta për



pushim mjekësor në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune me kompensim prej 70 % të pagës si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale që ndërlihet me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për institucionin, mirëpo vetëm nëse një gjë të tillë e konstaton institucioni i Mjekësisë së Punës apo institucionet e autorizuara të Mjekësisë së Punës në formë të ekspertizës, e që në rrethanat e rastit konkret Fletëlëshimi i datës 29.08.2023 i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës-Shërbimi Endokrinologjia sipas së cilës shkresë konstatohet fakti se ankuesit i është caktuar diagnoza përfundimtare "Diabetes mellitus tip 2 E11" dhe se për gjendjen në fjalë është mjekuar nga data 16.08.2023 deri me datë 29.08.2023 me propozimin për pushim mjekësor edhe për 7 ditë, Kolegji i Këshillit vlerëson se dokumenti/fletëlëshimi i lëshuar nga QKUK nuk e ka përmbajtur apo ekspertizën/kompetencën sikurse kërkohet me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.05/2012 për Kompensimin e Shpenzimeve për Lëndimet dhe Sëmundjet Profesionale të Shkaktuara në Punë, respektivisht nuk ka konstatim se diagnoza e caktuar ka ardhur *si rezultat apo si pasojë e lëndimit në punë apo të jetë caktuar si sëmundje profesionale që ndërlihet me kryerjen e punëve dhe shërbimeve për institucionin*, prandaj nga se u tha si më lartë pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Nga se u konstatua dhe u tha si më lartë, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në MINIT, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër:721/02 t datës 28.09.2023 përmes të cilit ankuesit ia ka refuzuar kërkesën e datës 08.09.2023 (për aprovimin e pushimit mjekësor me pagesë në vlerën e 70% të pagës për periudhën nga data 16.08.2023 deri me datë 06.09.2023), si dhe me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër:723/02 të datës 29.09.2023 përmes të cilit ankuesit i ka bërë ndalesë në pagë në vlerën prej 352.56 euro/cent, në emër të tejkalimit të pushimit mjekësor prej tetë (8) ditësh nga pushimi mjekësor i rregullt prej njëzet (20) ditësh, Kolegji i Këshillit konstaton se veprimet e tilla janë ndërmarrë në harmoni të plotë me nenin 12 paragrafi 4 të Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, si dhe nenin 12 paragrafi 6 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: "Pas kalimit të periudhës me kompensim, sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni, zyrtari publik me rekomandimin e organit kompetent mjekësor ka të drejtë të vazhdoj pushimin pa pagesë" ngase ndalesa në vlerën prej 352.56 euro/cent i është bërë në emër të tejkalimit të pushimit mjekësor prej tetë (8) ditësh nga pushimi mjekësor i rregullt prej njëzet (20) ditësh me pagesë prej 100% të pagës, respektivisht mungesës në punë pa pagesë prej 8 ditësh në emër të pushimit mjekësor, pasi që Fletë lëshimi i datës 29.08.2023 i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës-Shërbimi Endokrinologjia nuk ka përmbushur parakushtet ligjore dhe as referencat që diagnoza e caktuar për ankuesin ka të bëjë me sëmundje profesionale të ndërlihet me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për institucionin, prandaj aktet e guditura përmes kësaj ankesë kanë mbetur në fuqi sikurse në diapozitivin e këtij vendimi ndërsa ankesa e ankuesit është refuzuar si e pabazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.1241/2023

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrisë së Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.